

AKTI I THEMELIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ECO TREND CONSTRUCTION” SH.P.K

Sot më datë 05/01/2023, ne, të poshtëshënuarit:

Isuf Elezi, shtetas shqiptar, lindur me 03/12/1986, në Lugaj Elbasan, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me leternjoftin ID nr. 034959947 dhe nr. personal I61203053E.

Demir Tusha, shtetas Shqiptar, lindur më 10/08/1986, në Elbasan, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, i identifikuar me leternjoftimin ID nr. 038567550 dhe nr. personal I60810103D;

në përputhje me ligjin Nr.9901, date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ne Republikën e Shqiperise, vendosën të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar: “ECO TREND CONSTRUCTION” SH.P.K, më poshtë referuar si “Shoqëria”, duke nënshkruar, këtë Akt Themelimi.

Neni 1

EMRI I SHOQËRISË

1.1. Emri i Shoqërisë është “ECO TREND CONSTRUCTION” SH.P.K.

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË

- 2.1. Selia zyrtare e Shoqërisë “ECO TREND CONSTRUCTION SH.P.K. është në Elbasan, me adresë Rr. Tomorr Domi, Nd. 44, H.1, 3001, Elbasan.
- 2.2. Posta elektronike e Shoqërisë “ECO TREND CONSTRUCTION” SH.P.K është: (email)-info@ecotrendconstruction.com.
- 2.3. Veprimtaria e Shoqërisë do të shtrihet në te gjithë territorin e Republikës së Shqipërise, si dhe jashtë saj.

Neni 3

AFATI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

- 3.1. Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj dhe vepron si person juridik me personalitet të plotë për të vepruar për një kohë te pacaktuar.
- 3.2. Shoqëria mund të perfundoj apo vihet në likuidim perpara ketij afati vetëm me vendim të Ortakëve të saj.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

- 4.1. Shoqëria e ushtron veprimtarinë e saj ne përputhje me ligjin Nr.9901, date 14/04/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, legjislacionit ne fuqi dhe Statutit te saj me objekt si vijon:
 - Rikonstruksione godinash civile, ekonomike, veshje fasadash;
 - Punime karpentierie, murature, rifiniture, bojatisje, hidroizolim, termoizolim, akustike, kundra zjarrit;



- Projektim dhe ndertimi i objekteve civile apo industriale dhe menaxhimi i zbatimit te projekteve te kesaj natyre per vete dhe per te trete.
- Dhenie me qera, prodhim, montim, çmontim skele, import-eksport.
- Tregti me shumice e pakice materiale ndertimi e te gjitha llojeve te mallrave te lejuara nga legjislacioni shqiptar.
- Ofrimi i sherbimit te konsulences ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave, etj.
- Konsulence juridike dhe perfaqesim ligjor.
- Shitblerje automjetesh, autovetura, eskavator, kamiona, kamioncina, import-eksport, makineri te renda dhenie me qera.
- Shitblerje e pasurive te paluajtshme, dhenie me qira.
- Transport mallrash dhe pasagjeresh brenda dhe jashte vendit per llogari te vet dhe te trete
- Realizimi i kontratave, marreveshjeve, ortakerive, shoqerive te perbashketa apo te formave te tjera te lejuara nga legjislacioni shqiptar me persona fizik e juridik vendas apo te huaj per veprimtari tregtare, si dhe cdo lloj aktiviteti qe do te gjykohet me karakter fitimprures
- Hapjen dhe administrimin e bareve dhe restoranteve, pasticrive, etj.
- Prodhimin, magazinimin dhe shperndarjen e produkteve alimentare, nëpërmjet hapjes dhe menaxhimit të ushqimoreve, fruta perime, supermaket, minimarket, tabakino, etj.
- Projektim, realizim dhe administrim të parqeve ujore, etj.
- Shoqeria mund te bashkepunoje dhe/ose te marre direkt interesa, ne shoqeri, firma, agjensi dhe ndermarje te tjera, te cilat mund te kene edhe qellime te tjera aktiviteti.
- Gjithashtu, per te realizuar objektin dhe qellimet e saj, Shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje çdo lloj aktiviteti lidhur me, shitblerjen e pasurise te luajtshme dhe te paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhenes apo dorezanes, qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj.
- Shoqeria do te realizoje, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti lidhur me, si rezultat, apo qe ka lidhje me objektin e saj.

Neni 5

KAPITALI

- 5.1. Kapitali i nenshkruar dhe teresisht i paguar i shoqerise eshte **100.000 (njëqind mijë) lek.**

Neni 6

KUOTAT E KAPITALIT DHE ZOTËRIMI I TYRE

- 6.1. Kapitali eshte i perperbere nga **2 (dy) kuota kapitali**, te gjitha te nenshkruara dhe te paguara, ne vleren e përgjithshme të kapitalit prej **100.000 (njëqind mijë) lek.**
- 6.2. Kuotat e shoqerise zoterohen nga ortaket si me poshte:
- **Ortaku Isuf Elezi:** Zotëron **1 (një) kuotë** të kapitalit të Shoqërisë “ECO TREND CONSTRUCTION” SH.P.K, e barabartë me **51%** te kapitalit themeltar te Shoqerise. Vlera e kontributit te **Ortakut Isuf Elezi** eshte **51.000 (pesëdhjetë e një mije) lek.** Lloji i kontributit te **Ortakut Isuf Elezi** eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68, pika 5 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare
 - **Ortaku Demir Tusha:** Zotëron **1 (një) kuotë** të kapitalit të Shoqërisë “ECO TREND CONSTRUCTION” SH.P.K, e barabartë me **49%** te kapitalit themeltar te Shoqerise. Vlera e kontributit te **Ortakut Demir Tusha** eshte **49.000 (dyzetë e nëntë mijë) lek.** Lloji i kontributit te **Ortakut Demir Tusha** eshte ne para, sipas kuptimit te nenit 68 pika 5 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”.




Neni 7

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

- 7.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- 7.2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 7.3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.
- 7.4. Ortaket mund të rrisin pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
- 7.5. Administratoret/i njoftojne per regjistrim, prane Qendres Kombetare te Biznesit, vendimin per zmadhimin e Kapitalit. Vendimi publikohet edhe ne faqen e internetit te Shoqërisë.

Neni 8

TRANSFERIMI I KAPITALIT

- 8.1. Kuotat e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tremeve, teresisht apo pjeserisht, nepermjet:
 - a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimise;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.
- 8.2. Pjeset e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme nderrnjët ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.3. Pjeset e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 9

PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE

- 9.1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotes, nga casti i kalimit të kutoave.

Neni 10

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKEVE DHE ADMINISTRIMI

- 10.1. Shoqëria administrohet nga Administratori. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve emeron nje ose me shume persona fizik si Administrator, per nje periudhe 5 vjecare, me te drejte ripërteritjeje.
- 10.2. Nepermjet ketij akti, emerohet Administrator, **Z. Isuf Elezi**, për një periudhë 5 vjeçare.
- 10.3. Administratori ka të drejtë të veprimeve personalisht ose duke i deleguar personave të treme, lidhur me të gjitha procedurat për regjistrimin e shoqërisë prane organit kompetent. Ai është i autorizuar të veprimeve për llogari të shoqërisë derisa regjistrimi i saj të ketë përfunduar.



- 10.4. Administratorit te siperpermendur i jepen te gjitha te drejtat e administimit, te zakonshem e te jashtezakonshem, duke perfshire edhe nenshkrimin dhe ekzekutimin e te gjitha akteve ne emer dhe per llogari te Shoqerise dhe gjithashtu mund te delegoje pushtetin e tij te persona te trete, me autorizim te nenshkruar dhe te vulosur me vulen e shoqerise ose me prokure te posacme te noterizuar.
- 10.5. Asambleja e Pergjithsme e Ortakeve drejton dhe kontrollon gjithe aktivitetin e shoqerise "ECO TREND CONSTRUCTION". Ortaket e shoqerise perballojne humbjen deri ne kufirin e vleres se kontributit te tyre.
- 10.6. Administratori, gjate ushtrimit te profesionit te tij duhet te mos jete ne asnje moment ne shkelje te akteve ligjore e nenligjore qe percaktojne shperdorim te detyres, si dhe te ushtroj funksione te tjera qe jane te papajtueshme me ligjin.
- 10.7. Te drejtat, detyrimet dhe kompetencat e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe Administratorit percaktohen ne menyre shteruese ne statutin e Shoqerise.

Neni 11

DISPOZITAT E FUNDIT

- 11.1. Ndryshimet ne kete AKT mund te behen vetem me shkrese dhe vendim te miratuar nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
- 11.2. Çdo mosmarreveshje qe lind ne lidhje me kete akt themelimi apo me Shoqerine, do te zgjidhet me mirekuptim midis paleve, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, ose gjykata qe do te kete jursdiksion dhe kompetencen lendore apo toksore brenda territorit te Republikes se Shqiperise
- 11.3. Pjese e pandare e ketij akti eshte Statuti i shoqerise i cili nenshkuhet rregullisht nga themeluesit e Shoqerise "ECO TREND CONSTRUCTION" Shpk.
- 11.4. Ngarkohet **Ortaku Isuf Elezi**, të kryej të gjitha veprimet e nevojshme pranë QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit), për regjistrimin e Shoqërisë.

Ky Akt Themelimi u hartua në Elbasan, në 3 (tre) kopje origjinale, i cili nënshkruhet rregullisht konform ligjit.

THEMELUES

Isuf ELEZI



Demir TUSHA

